

VENDIM
Nr.1273, datë 17.9.2008

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë, sipas fakulteteve:

a) Në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike:

i) Programi i studimit “Inxhinieri tekstili dhe mode”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri tekstili dhe mode.

b) Në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit:

i) Programi i studimit “Inxhinieri ndërtimi”, me profile:

- Ndërtim dhe administrim;

- Strukturist;

- nfrastrukturë e transportit.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, profili ndërtim dhe administrim;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, profili strukturist;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, profili infrastrukturë e transportit.

ii) Programi i studimit “Inxhinieri hidroteknikë”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri hidroteknikë.

iii) Programi i studimit “Inxhinieri gjeodezi”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeodezi.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha